REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: Primljeno: 04. 06 2021		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
11-030-	30033	

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje te nenit 12 par.1, 2 shkronja d, neni 17 par.1 shkronja 6 , të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L040, qershor 2008, neni 5 nenparagrafi 1.2 pika 1.2.2, neni 10 par.2 pika 2.1 , neni 11 dhe neni 16 të Ligjit për Plinifikim Hapësinor Nr.04/L-174, Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr.24/2015 Mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartes Zonale të Komunës, Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr.08/2017 Mbi Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor , Vendimi për Pëlqim Mjedisor për VSM të HZK nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit Nr.252-2/21 dt.22.02.2021, Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 03.06.2021, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM
PER MIRATIMIN E HARTËS ZONALE TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

Mekëtë Vendim miratohet Projekt Dokumenti: Harta Zonale e Komunës së Lipjanit për periudhën kohore 2021-2029.

Neni 2

Harta Zonale e Komunës së Lipjanit është një dokument multi-sektorial që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës, për periudhën kohore tetë (8) vjeçare 2021-2029.

Neni 3

Projekt Dokumenti: Harta Zonale e Komunës së Lipjanit për periudhën kohore 2021-2029 nga neni 1 i këtij Vendimi përmban pjesën tekstuale dhe grafike, Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor në kopje fizilke dhe digjitale dhe është pjesë përbërese e këtj Vendimi.

Neni 4

Me hyrjen në fuqi të Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit shfuqizohet Plani Zhvillimor Urban 15Nr.12514 dt.23.08.2013 dhe Planet tjera integrale të nivelit me të ultë.

Neni 5

Per zbatimin e këtij Vendimi kujdesen të gjitha organet ekzekutive të Komunës

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. 30033

Lipjan, më 03. 06. 2021

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi